



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2025

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 802, datë 23.9.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, **znj. Flora Çela**.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Për kompetencë: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 28.10.2024 dhe parashtrimeve të depozituara në seancën publike të datës 7.7.2025, vlerëson se:

I. Për vlerësimin e aftësive profesionale

1. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, vlerëson se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit, për çështjet e mëposhtme:

2. *Procedimi penal, nr. ***, datë **.7.2017, regjistruar për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe e municionit”, si dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 283/2, 278 dhe 287 i Kodit Penal.*

2.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësojmë se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta. Vendimmarrja dhe veprimet e subjektit të

rivlerësimit, tregojnë një model pune të dobët dhe jo profesional, për sa do trajtohet në vijim:

2.2. Nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se procedimi penal nr. ***/2017, është regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria e Policisë Vendore Vlorë, për veprat penale *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”*, *“Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe municionit”*, parashikuar nga neni 283/2, 278/1 i Kodit Penal, ku sipas informacionit për referimin e veprës penale në Prokurori janë gjetur e sekuestruar në cilësinë e provës materiale 9166 kg e 600 g lëndë narkotike e llojit *cannabis sativa*, 112 kg e 500 g e llojit hashash, armë zjarri automatike kallashnikov, si dhe një arkë me fishekë. Prokuror i çështjes është subjekti i rivlerësimit.

2.2.1. Nga informacionet e disponuara ka rezultuar se persona të dyshuar për këtë veprë penale janë shtetasit *** ***, *** *** dhe *** ***, familjarë mes tyre, të cilët dyshohen se në bashkëpunim edhe me persona të tjerë, kanë grumbulluar me qëllim shitjen më tej të lëndës narkotike. Shtetasit **. **. dhe **. **. janë arrestuar në flagrancë, ndërsa shtetasi **. **. nuk është gjetur në vendin e ngjarjes dhe as në vendin e tij të punës, *** *Kafe Restorant*, në Vlorë.

2.2.2. Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, tri ditë pas regjistrimit të procedimit penal nr. ***/2017, me shkresën nr. ***, datë ***.7.2017, ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, materiale procedurale lidhur me referimin e veprës penale të *“Prodhimit dhe shitjes të bimëve narkotike”*, parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal, ku ndër të tjera, përshkruhet se: [...] *Gjatë kontrollit të mëtejshëm të këtij territori është konstatuar se nga ana lindore e përroit, ku ndodhet parcela me ullinj e shtetasit **. **. dhe në afërsi të koshereve të bletëve që ndodheshin brenda kësaj baçe, u konstatua një thes i zi, brenda të cilit kishte shtatë qese plasmasi... Nga peshimi i bërë lëndës narkotike gjetur te kosheret e bletëve, si dhe në anë të gardhit, u konstatua një peshë prej 26 kg e 400 g. Më pas vazhdoi kontrolli në përrua, ku u konstatuan dyzet e tre qese plasmasi me ngjyrë të zezë... me peshë 670 kg e 300 g... Shtetasi **. **. deklaroi se...toka matanë përroit është e shtetasit **. **. , në lidhje me bletët kam kohë pa vajtur andej dhe nuk kam dijeni të kujt janë [...]. Me vendimin për bashkimin e procedimit penal datë **.7.2017 është vendosur bashkimi i procedimit penal nr. ***/2017 me procedimin e mësipërm me nr. ***/2017 duke qenë se në të dy procedimet penale bëhet fjalë për të njëjtin person të dyshuar **. **. dhe faktet kanë lidhje mes tyre.*

2.2.3. Nga aktet, rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën **.4.2019, në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. ***, të filluar më datë **.7.2017, ka drejtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesën për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve **. **, dhe **. **. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.7.2019, ka vendosur: [...] *Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017, të regjistruar për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe*

e municionit”, parashikuar nga neni 278 i K. Penal dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 278 i K. Penal [...]¹.

2.3. Rrethanat e ngjarjes, të dokumentuara nga aktet në dosje, lidhur me: (1) informacionet e qëndrueshme dhe veprimet operationale të organeve ligjzbatuese; (2) sasinë e konsiderueshme të lëndëve narkotike të sekuestruara; (3) faktin që lëndët narkotike ishin të paketuara dhe gati për transport; (4) rrezikshmërinë dhe sasinë e armëve të konfiskuara; si dhe (5) faktit që mes të dyshuarve kishte dhe zyrtarë me funksione publike² (prania e një zyrtari të fshatit dhe oficerëve të policisë ndër të arrestuarit), janë tregues që rasti duhej trajtuar sipas nenit 283/a, “*Trafikimi i narkotikëve*” dhe nenit 284/a, “*Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale*”, të Kodit Penal, duke pasur parasysh se kjo çështje përmbante elemente të një operacioni të madh të trafikimit të organizuar të lëndëve narkotike, në të cilin duket se askush nuk u shpall përgjegjës për rreth 16 tonë kanabis të paketuara dhe për armët e sekuestruara.

2.4. Subjekti i rivlerësimit edhe gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, dështoi ti përgjigjej pyetjes së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nëse në përfundim të hetimit disa vjeçar të këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit kishte mundur të zbulonte se cili ishte destinacioni i gjithë kësaj sasive lënde narkotike, duke nxjerrë në pah mangësi dhe hetim të dobët të kryer nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e çështjes penale 1174/2017.

2.5. Edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, lidhur me mungesën e transferimit të këtij rasti për kompetencë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, në parashtrimet e depozituara, subjekti i rivlerësimit paraqiti të njëjtat argumenta si ato në Komision, ku ndër të tjera, deklaroi se ishte periudha që Prokuroria për Krimet e Rënda ishte duke u mbyllur, dhe materialet ishin duke u dërguar në prokuroritë e rretheve dhe ndodhën dhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale 2017.

2.5.1. Gjithashtu, në mënyrë të gabuar, ashtu sikundër u konstatua edhe gjatë debatit gjyqësor në seancën e datës 7.7.2025 në Kolegj, subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me praktikën gjyqësore, referuar formës së bashkëpunimit në realizimin e veprës penale, nuk ka analizuar si dhe nuk ka marrë parasysh të gjithë elementët që bëjnë dallimin midis një bashkëpunimi të thjeshtë dhe atij të posaçëm, siç në këtë rast janë: sasinë e mëdha të lëndës narkotike, *modus operandi*, aftësia për të kultivuar lëndën narkotike, aftësia për të grumbulluar të gjithë lëndën narkotike dhe përgatitja për t’u transportuar, procese këto të cilat nuk mund të realizohen në një bashkëpunim të thjeshtë. Edhe gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dështoi të japë argumenta lidhur me këtë kualifikim ligjor të bërë nga vetë ajo, në cilësinë e prokurores së çështjes.

¹ Referuar shënimit të sekretarisë, ky vendim ka marrë formë të prerë, më datë **.7.2019, pasi nuk u ankimua.

² Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar një tjetër procedim penal me nr.*/2017, në përfundim të të cilit ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesën penale me objekt “Gjykimin e procedimit penal nr.*/2017, në ngarkim të shtetasve **. **, **, **, **, dhe **, të akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, në bashkëpunim dhe “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga nenet 284/2 dhe 248 të K. Penal”.

2.5.2. Në këto rrethana, duket se subjekti i rivlerësimit, më së paku, ka vepruar me një neglizhencë të dukshme e me një qasje gati të paracaktuar, drejt mostrajtimimit të rastit si krim i kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit. Pretendimet e subjektit lidhur me mungesën e transferimit të çështjes pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, konsiderohen jo bindëse, pasi nisur nga rrethanat e konstatuara, vlerësohet se rasti ishte plotësisht brenda juridiksionit të Gjykatës për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, ndërkohë që Prokuroria e Krimeve të Rënda ka ushtruar aktivitetin edhe për rreth dy vite të tjera pas regjistrimit të këtij procedimi penal, dhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale ishin pa ndikim në këtë proces.

2.6. *Lidhur me ekzaminimin e pajisjes elektronike DVR, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, nga aktet në dosje ka rezultuar, se nga oficeri i Policisë Gjyqësore, në kuadër të veprimeve të para hetimore, më datë 13 korrik 2017, gjatë kontrollit në restorantin “Bar ***”, në pronësi të shtetasit **. **, Uji i Ftohtë, Vlorë, ishte sekuestruar një pajisje elektronike DVR, e ambientit të lokalit, material i cili mund të kishte siguruar të dhëna mbi kontaktet e personave të përfshirë. Përmbajtja e DVR-së rezultoi se u ekzaminua më datë 15 qershor 2018, pothuajse një vit pas sekuestrimit dhe referuar procesverbalit të këqyrjes, rezultoi se: [...] lidhet aparati me ushqyesin e saj dhe lidhet me energjinë elektrike. Pasi shtypet butoni i ndezjes së aparatit vërehet se aparati nuk ndizet. Gjë tjetër me interes nga këqyrja nuk rezultoi [...].*

2.6.1. Ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit, *vlerësojmë* se për të arritur në një konkluzion të tillë, kjo pajisje duhet ti ishte nënshtruar ekspertimit nga ekspertet e laboratorit të Policisë Shkencore të cilët janë të vetmit që mund të përcaktojnë nëse kjo DVR mund të gjenerojë ose jo të dhëna apo pamje, foto, video, etj, vendim ekspertimi ky që siç u provua dhe gjatë debatit gjyqësor në seancën e datës 7.7.2025, nuk rezultoi të jetë urdhëruar nga subjekti i rivlerësimit.

2.7. *Lidhur me masat e sigurisë të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, për të dyshuarit “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, nisur nga rrethanat e ngjarjes, duken tërësisht të papërshtatshme, veçanërisht duke pasur në konsideratë se për një nga të dyshuarit, shtetasin **. **, rezultoni të dhëna të regjistruara në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, që prej vitit 1999. Vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, në vendimet lidhur me caktimin e masave të sigurisë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] Gjykata arrin në konkluzionin se e vetmja masë efektive është e aftë për të siguruar normalitetin e vazhdimësisë së hetimit dhe gjykimit eventualisht të çështjes është ajo e “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K. P. P, duke u përjashtuar çdo masë tjetër sigurimi më e butë. Pavarësisht sa më sipër, Prokuroria ka parashtruar kërkesën që ndaj shtetasit nën hetim **. **, të caktohet masa e sigurimit personal “Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K. P. P. Gjykata vlerëson se kjo masë nuk është e përshtatshme. Në nenin 244/3 i K. P. P, parashikohet ky ndalim ligjor: “Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë sesa ajo e kërkuar nga prokurori” [...].*

2.7.1. Në kërkesat “Për vlerësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, për shtetasit **.**, dhe **.**, të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, referuar arsyetimit të

aktit, nuk rezulton të jetë bërë individualizimi i rrethanave për secilin prej të hetuarve që të provojnë kërkesën për këtë lloj mase sigurimi, rrethana që kanë të bëjnë me rrezikshmërinë shoqërore të autorëve, veprave, etj. Gjithashtu, pavarësisht rrethanave të rastit si dhe kërkesës së subjektit të rivlerësimit për vlerësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë për shtetasit **.**, dhe **.**, në argumentet e paraqitura në Kolegj gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes si dhe ato të paraqitura në kërkesën për caktim mase sigurimi, duket se subjekti i rivlerësimit në trajtimin e rastit, ka *zbehur duke vënë në dyshim* ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, ekzistenca e të cilës është kusht pa të cilin nuk mund të vendoset një masë sigurie, pavarësisht llojit të saj.

2.8. *Lidhur me regjistrimin e procedimit pasuror mbi personat e hetuar në procedimin ***/2017*, pavarësisht informacioneve, lidhur me mosjustifikimin e pasurive të personave të përfshirë, referuar debatit gjyqësor në seancën e datës 7.7.2025, mbeti e provuar se nuk janë ndërmarrë veprime të tjera hetimore në drejtim të përcaktimit të mundësisë financiare të të gjithë pjesëtarëve të familjes ***, për të krijuar pasuritë e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, duke përjashtuar nga analiza financiare shtetasin ** **, shtetas i cili ishte i regjistruar si person nën hetim për veprat penale të *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”* dhe *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*.

2.8.1. Subjekti i rivlerësimit, gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, në përgjigje të pyetjes së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, deklaroi se ka bërë verifikime në kuadër të procedimit penal dhe për sa kohë që nuk është provuar vepra bazë, nuk ka patur ndonjë detyrim për të regjistruar edhe procedimin pasuror, si dhe konfirmoi se nuk ka pasur një procedim pasuror të regjistruar.

2.8.2. Sa më sipër mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor në funksion të regjistrimit të procedimit pasuror mbi personat e hetuar në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, edhe pse ky i fundit nuk kërkon provimin e veprës penale bazë ose vendim fajësie të formës së prerë, për fillimin e procedimit pasuror.

2.9. *Lidhur me ballafaqimin e shenjave të gishtave në qeset ku u sekuestruan bimët narkotike* me shenjat e gishtave në bazën e të dhënave të Policisë së Shtetit, në dosje gjendet i administruar një vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik dhe për të përcaktuar nëse në sipërfaqen e qeseve brenda të cilave ndodhet lënda narkotike konstatohen gjurmë papilare, që daton më **.6.2018, rreth një vit më vonë nga data e sekuestrimit.

2.9.1. Gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë marrë një vendim të dedikuar, për krahasimin dhe ekspertimin daktiloskopik, për të urdhëruar Institutin e Policisë Shkencore që të bëjë një krahasim të dedikuar mes gjurmëve të përfutuara gjatë procesit të ekzaminimit të provave të gjetura në vendin e ngjarjes, (qese, armë etj,) dhe gjurmëve të marra subjekteve nën hetim, të

cilët nuk figurojnë të skeduar në *database*-n e Institutit të Policisë Shkencore, por është mjaftuar me krahasimin automatik të sistemit.

2.10. Edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, mbeti e provuar se, pavarësisht se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, më **.12.2017, ka përcjellë *një analizë të të dhënave për llogari të hetimit telefonik në lidhje me procedimin penal nr. ***/2017*, të administruara nga kompanitë celulare, nga organi i Prokurorisë nuk duket të jenë bërë përpjekje për të kontaktuar personat mbartës të këtyre numrave të telefonit, për të marrë dëshmitë e tyre.

2.11. Po ashtu mbeti e provuar se, referuar procesverbalit për pyetjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, subjekti i rivlerësimit ka marrë në pyetje shtetasin **. **, vetëm më datë **.4.2019, pothuajse dy vite nga sekuestrimi i bimëve narkotike, pas arrestit në flagrancë dhe në dosje nuk rezulton të jetë dokumentuar “*Ftesa për paraqitje*”, ndaj shtetasit **. **, në kundërshtim me parashikimet e nenit 308 të Kodit të Procedurës Penale.

2.12. Edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit, nuk duket se ka kryer ndonjë veprim hetimor lidhur me përcaktimin e pronësisë së koshereve të bletëve, që ndodheshin shumë afër me tokën ku është sekuestruar bima narkotike, për të cilën banorët e zonës dëshmonin se është në pronësi të shtetasit **. **. Rezulton se janë marrë dëshmi të banorëve të zonës rreth shtëpisë ku policia sekuestroi bimët narkotike, por këto dëshmi janë marrë në korrik të vitit 2018, sërish *rreth 1 vit pas veprimeve operacionale të policisë*. Po ashtu, rezulton se Prokuroria, vetëm më datë **.7.2018, i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes Tokës, Vlorë, për marrjen e informacionin mbi parcelat e tokës në pronësi të shtetasit **. **..

2.13. *Lidhur me deklarin e subjektit të rivlerësimit mbi dënimet e dhëna ndaj shtetasve të proceduar*, gjatë seancës dëgjimore në Komision, subjekti ka deklaruar ndër të tjera se: *për çështjen konkrete kam arrestuar rreth 10 shtetas, të cilët janë dënuar nga ana ime dhe kam dhënë më shumë se 60 vjet dënim në këtë çështje*.

2.13.1. Referuar akteve të procedimit penal nr. ***/2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka drejtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesën për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve **. **, **. **, dhe **. **, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. **, datë **.7.2019.

2.13.2. Ndërsa lidhur me procedimin penal ***/2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit në përfundim të gjyqimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka kërkuar sa vijon:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit **.**, i akuzuar për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim;*

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **.**, me detyrë SPZ, specialist në Komisaratin e Policisë Vlorë, i akuzuar për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim;

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **.**, i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim;

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **.**, i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.

2.13.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë **.6.2018 ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit **.**, për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe dënimin e tij me 6 vjet burg në aplikim të nenit 406 të K.Pr.P. është dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim dhe deklarin e pafajshëm për të pandehurit e tjerë **.**, **.**, dhe **.**. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë e cila me vendimin nr. **, datë **.3.2019 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 20.6.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me ndryshimin:

- Në bazë të nenit 284/1 të Kodit Penal dënimin e të pandehurit **.**, me 4 vjet burgim.
- Në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penal i ulet 1/3 e dënimit dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit **.**, me 2 vjet e 8 muaj burgim.

2.13.4. Sa më sipër, vlerësojmë se mbeti e provuar se lidhur me këto dy procedime penale, është dënuar vetëm një shtetas për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike” të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe nuk rezulton asnjë i dënuar lidhur me sasinë e madhe të lëndës narkotike të sekuestruar në kuadër të procedimit penal nr. ***/2017.

2.14. Trajtimi i rastit nga subjekti i rivlerësimit, më së paku, nxjerr në pah mangësi dhe hetim të dobët të kryer nga subjekti i rivlerësimit, çka ka bërë të pamundur, zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes, rolit dhe përgjegjësisë së secilit pjesëmarrës në të, situatë faktike e cila vë në dyshim serioz thelbin e vendimmarrjes së prokurores për akuzat e personave të përfshirë në procedimin penal, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

2.15. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së të datës **.10.2024, bazuar në nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim tërësor të çështjes, vlerëson se gjetjet e rezultuara nga kontrolli i kriterit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, parë dhe në dritën e rrethanave të dala nga administrimi i plotë i dosjes, sa i përket procedimit penal nr. ***/2017 dhe procedimeve të tjera të lidhura me të, nuk janë bindëse, janë kontradiktore dhe rezulton se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. Nga ana e subjektit të rivlerësimit është kryer një hetim i paplotë, si dhe nuk janë mbledhur të gjitha provat

e kërkuara, për qartësimin e rrethanave të rastit në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

2.16. Rrethanat e rezultuara më sipër, duhet të vlerësohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, së bashku me gjetjet e tjera të aspektit profesional, për të cilat Komisioni ka dalë me vendim të ndërmjetëm nr. 4 datë 17.10.2023, duke vendosur *“Pezullimin nga detyra të znj. Flora Çela për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”*. Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, vlerësojmë se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës të Komisionit dhe njëkohësisht të shkaqeve të ankimit, për sa vijon:

2.17. *Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë **.9.2017³, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës **.7.2025, vlerësojmë se sikundër konstatuar edhe nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e konstatuara në ankim, lidhur me këtë çështje, mbeten të njëjta. Rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer hetime shteruese, si dhe nuk ka konsideruar “sigurimin e padisë” apo çdo të dhënë tjetër të dalë gjatë hetimit dhe, për pasojë, nuk është vlerësuar drejt fakti penal⁴; (b) vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit si detyrë e lënë nga gjykata është marrë në kohë relativisht të gjatë nga vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, datë **.10.2020; (c) nuk pasqyrohen në dosje veprime hetimore të kryera deri në caktimin e kryerjes së aktit të ekspertimit.*

2.18. *Lidhur me denoncimin e shtetasve **. **, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës **.7.2025, vlerësojmë se sikundër konstatuar edhe nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, mbeti e provuar se vendimi i mosfillimit të datës **.10.2021 (edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit për ekzistencën e muajit gusht, si kohë e kryerjes së pushimeve vjetore) është marrë në tejkalim të afatit 15-ditor, sikurse parashikohet në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale.*

2.19. *Lidhur me denoncimin e shtetasit **. **, trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 7.7.2025, vlerësojmë se sikundër konstatuar edhe nga Komisioni, subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës. Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, konstatohet se subjekti: (a) është vënë në lëvizje në intervale të gjata kohore për marrjen e akteve, duke proceduar në tejkalim të afateve kohore të arsyeshme; (b) ka marrë vendim thuajse pas 3 muajve nga nisja e rihetimit datë **.3.2021, me datë **.5.2021 (njoftuar denoncuesit më **.6.2021), për bërjen e aktit të ekspertimit, duke mos ndërmarrë në kohë veprimin e lënë nga Gjykata. Subjekti i rivlerësimit, dhe në këtë rast, ka shfaqur mangësi në drejtim të administrimit të akteve dhe mbikëqyrjen e tyre, ka ceduar në efektivitetin e zbatimit të procedurave brenda afateve kohore.*

³ Regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazë të kallëzimit të shtetasve **. **, dhe **. **.

⁴ Shtetasi **. **, rezulton përfundimisht i dënuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, me vendimin nr. ***/***, datë **.5.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë.

2.20. *Lidhur me denoncimin e shtetases **.* **, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 7.7.2025, *vlerësojmë se* edhe në rastin konkret, në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të identifikimit të elementeve të veprës tjetër penale të “Vetëgjyqësisë”, ashtu sikurse kishte konstatuar edhe Gjykata mbi vendimet e subjektit, të cilat rezultuan të prishura dhe iu kthyen subjektit për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, në drejtim të kualifikimit të veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i K. Penal.

2.20.1. Subjekti i rivlerësimit shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore; si dhe në aspektin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.21. *Lidhur me denoncimin e shtetasit **.* **, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 7.7.2025, *vlerësojmë se* edhe në rastin konkret, në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit ka munguar të kryejë veprimet hetimore në kohë, sikurse ka disponuar me vendim për kryerje të aktit të ekspertimit për verifikim në terren të apartamenteve, në datën **.12.2021, pas tri muajve nga regjistrimi i procedimit penal datë **.9.2021. Gjykata, në dy raste, e ka kthyer vendimin Prokurorisë, për hetime të mëtejshme.

3. Në përfundim të sa më sipër, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së datë 16.10.2024, vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë të tilla që nuk mund të korrigjohen përmes programit një vjeçar të edukimit të Shkollës së Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit, i gjendur në situatat e mësipërme të shkeljes së ligjit, ka një model pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe nuk arrin të përmbushë kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 4 e aneksit të Kushtetutës.

4. Për më tepër, këto rrethana, të konstatuara dhe nga vetë Komisioni, së bashku me gjetjet e procedimit penal nr. 1174/2017 dhe nr. 1182/2017, përbëjnë një bazë të dhënash të mjaftueshme mbi të cilën, bazuar në nenin 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që bëjnë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

III. Kërkimi i ankimit

5. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 28.10.2024, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe

7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 802, datë 23.9.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela.

DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME

Altin DUMANI